



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 14 qershor 2010
Nr. ref.: URDH 33/10

URDHËR

Rasti nr. KI 11/09

Tomë Krasniqi

dhe

Radiotelevizioni i Kosovës (në tekstin e mëtejme RTK) dhe Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejme KEK)

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SE KOSOVES

e përbëre nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalovič, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Hyrje

1. Gjykata Kushtetuese thirret në Vendimin e vet të 16 tetorit 2009 lidhur me kërkesën në fjalë. Në atë vendim, Gjykata lejoi një masë të përkohshme për zbatimin e mëtejme të dispozitave të nenit 20.1 të Ligjit mbi Radiotelevizionin e Kosovës, në pritje të një vendimi mbi meritat e kërkesës. Gjykata gjithashtu i rekomandoi Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta shqyrtonte, deri në dhjetor të vitit 2009, natyrën e nenit 20.1 të Ligjit mbi Radiotelevizionin e Kosovës, dhe praktikën duke u bazuar në dispozitat e atij ligji në pritje të një vendimi përfundimtar të Gjykatës mbi meritat e kërkesës.
2. Ky vendim iu komunikua palëve, Kuvendit të Kosovës, u publikua me kohë, dhe hyri në fuqi që nga momenti që ishte marrë.

Korrespondenca nga Kuvendi i Kosovës

3. Në bazë të atij vendimi të publikuar në kohë, Kryetari i Kuvendit të Kosovës iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me një letër, me 30 prill 2010, në të cilën kishte bashkangjitur një memorandum, të 29 prillit 2010, që Komisioni për Administratë Publike, Administratë Lokale dhe Media ia kishte drejtuar Kryetarit të Kuvendit.
4. Memorandumi ofronte informata mbi hapat që ishin ndërmarrë nga Kuvendi lidhur me ndryshimet e propozuara në Ligjin mbi Radiotelevizionin e Kosovës. Memorandumi i referohej, ndër të tjera, themelimit të një grupi punues me ekspertë për t'i hartuar ndryshimet e propozuara në këtë ligj, për hartimin e ndryshimeve, për përgatitjen e planit vjetor të punës për t'i përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, për prezantimin e kësaj pune Komisionit Parlamentare dhe për qëllimin për ta vazhduar punën në ndryshimin e Ligjit mbi Radiotelevizionin e Kosovës. Memorandumi gjithashtu konfirmoi se Kuvendi i Kosovës kishte miratuar Vendimin Nr. 03/237 për financim të përkohshëm të RTK-se për periudhën prej 1 janarit deri me 30 qershor 2010.
5. Gjykata sjell ndër mend me sa vijon:
 - i. ndikimin e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese në lejimin e masës së përkohshme për zbatimin e nenit 20.1 të Ligjit në fjalë,
 - ii. përpjekjet që i janë paraqitur Gjykatës për të siguruar pajtim me rekomandimet e saj, dhe
 - iii. kufizimet kohore që mund të hasen nga Kuvendi në zbatimin e ligjeve të reja në lidhje me ndryshimin e Ligjit mbi Radiotelevizionin e Kosovës.

Gjykata, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje më 14 qershor 2010, me shumicë votash:

VENDOS

- I. Ta vazhdojë masën e përkohshme të lejuar nga Gjykata në Vendimin e vet të 16 tetorit 2009 deri me 1 janar 2011;
- II. Kërkon nga Kuvendi i Kosovës që ta njoftojë Gjykatën në kohë të duhur në lidhje me pajtueshmërinë me rekomandimin e vet para 1 janarit 2011;
- III. Mbetet e angazhuar fuqimisht në këtë çështje në pritje të shqyrtimit të mëtejshëm; dhe
- IV. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtresit të kërkesës, palëve, Kuvendit të Kosovës, dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Dr. Iliriana Islami, d.v.



Kryetari i Gjykatës

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.